



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
"HASAN PRISHTINA"
UNIVERSITY OF PRISHTINA

Rr. Xhorxh Bush, Ndërtesa e Rektoratit, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovës
Tel: +381 38 244 183 • E-mail: rektorati@uni-pr.edu • www.uni-pr.edu

Rektor
Prof. Dr. Marjan DEMA

Nr. Prot.: 3/143
Datë: 31/10/2017

Senati i Universitetit të Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më datën 31.10.2017, mori

V E N D I M

- I. Lejohet vazhdimi i kohëzgjatjes së studimeve/diplomimit për studentët e vitit të fundit të studimeve dhe për studentët që kanë ndëgjuar ligjëratat në nivelin bachelor dhe master, e të cilët nuk kanë arritur që ti përfundojnë studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve dhe që kanë arritur numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet.
- II. Vazhdimi i kohëzgjatjes për përfundimin e studimeve për studentët si në pikën I të këtij vendimi, lejohet përfundimisht deri më 30.9.2018.
- III. Periudha e suspendimit të përkohëshëm të statusit të studentit të rregullt në bazë të nenit 152 të Statutit nuk llogaritet në kohëzgjatjen e studimeve.
- IV. Studentët të cilët nuk arrijnë që brenda periudhës së lejuar sipas pikës II të këtij vendimi të përfundojnë studimet (diplomojnë), mund të konkurrojnë përmes konkursit publik për pranim në programe të njëjta apo programe tjera studimi. Pas pranimit, komisioni i studimeve e bënë ekuivalentimin e provimeve që i njihen në programin e ri të studimit.
- V. Njësitë akademike obligohen që vendimin ta publikojnë në tabelat e shpalljeve në njësitë përkatëse akademike.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi nga dita e miratimit në Senat.

Arsyetim

Senati pasi shqyrtojë me kujdes kërkesën e njësive akademike dhe studentëve për lejimin e vazhimit të kohëzgjatjes së studimeve/diplomimit për studentët në nivelin bachelor dhe master të studimeve në njësitë akademike të Universitetit të Prishtinës, të cilët kanë kaluar periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve dhe që kanë arritur numrin maksimal të regjistrimit të serishëm të viteve pa i përfunduar me sukses studimet e konsideroj si të arsyeshme kërkesën, prandaj vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi t'i dërgohet:

1. Arkivit të UP-së;
2. Dekanëve të njësive akademike;
3. Sekretarëve të njësive akademike;
4. Sekretarit të përgjithshëm të UP-së;
5. Për publikim në ueb-faqe.



REKTORI

Prof. dr. Marjan Dema